




**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR**

**RELACION
MBI
SHPENZIMET BUXHETORE**

Periudha

01.01.2017 – 31.12.2017

PLANI FINANCIAR DHE REALIZIMI PER VITIN 2017



**ANALIZË
E REALIZIMIT TË TREGUESVE BUXHETORË
PËR VITIN 2017**


I – Shpenzimet faktike të kryera

Totali i shpenzimeve


Shpenzimet e përgjithshme, të realizuara për DSIK, për periudhën Janar - Dhjetor 2017, janë: **48,010,105 lekë.**

Në nivel artikuj buxhetorë, shpenzimet faktike në milion lekë dhe raporti në % ndaj totalit, paraqiten:

Në milion/Lekë



Pesha ne % që zenë artikujt në raport me totalin e shpenzimeve.




Nga të dhënat, vërehet se, ndaj totalit të shpenzimeve, shpenzimet për pagat zënë pjesën kryesore me 50 %, shpenzimet për mallra e shërbime 23 %, shpenzimet për ISSH 9 % dhe shpenzimet për investime 18 %. Shpenzimet e kryera për vitin 2017 janë realizuar të gjitha nga buxheti i shtetit.

II – Realizimi shpenzimeve të miratuar për vitin 2017 ndaj planit vjetor

Totali shpenzimeve:


Buxheti i miratuar për 12 mujorin ndaj shpenzimeve faktike **është realizuar 92 % duke rezultuar me një mosrealizim prej 8% ose 4 milion lekë.**



Sipas **grupeve kryesore të shpenzimeve, per vitin 2017, kundrejt planit vjetor**

- Shpenzime Personeli (art.600 + 601): 94 %, mbetja - 1.9 milion lekë.
- Shpenzime Operative (artikulli 602) : 95 %, mbetja - 0.5 milion lekë.
- Investime (artikulli 231): 82 %, mbetja - 1.9 milion lekë.

Shpenzimet faktike dhe mos realizimi, në milion lekë, paraqiten:



Mosrealizimet ndaj vjetorit në shpenzimet e personelit, shpenzimet e tjera (mallra e shërbime) dhe shpenzimet kapitale, janë në masën 4 milion lekë ose 8% e fondeve vjetore të planifikuara.

- Në artikullin 600 “Paga personeli”, fondet e miratuara për vitin 2017 për numrin limit të punonjësve të miratuar për vitin 2017 janë realizuar në masën 94%.

Mosrealizimi në masën 6%, vjen si rezultat i mosplotësimit të pozicioneve vakant, të një pozicioni me leje lindje dhe të disa pozicioneve të paplotësuara për katër muaj, si rezultat i pritjes së mbarimit të procedurave të konkurimit për punonjësit e rinj.

- Përlllogaritja e fondit të pagave ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në përlllogaritjen e fondit të sigurimeve shoqërore (artikulli 601) të cilat janë realizuar në masën 95% për vitin 2017.

- Artikulli 231 “Investime” është realizuar në masën 82%, duke bërë të mundur realizimin e projekteve të parashikuara. Fondet e mbetura në këtë zë shpenzimesh, janë si rezultat i përlllogaritjes së fondit limit në procedurat e tenderimit më pak se parashikimi.

**Nëpunëse Zbatuese në DSIK
K.BEJKO**